



INSTITUCIONET E PËRKOHSHME TË VETQEVERISJES  
PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF-GOVERNMENT  
PRIVREMENE INSTITUCIJE SAMOUPRAVLANJA

QEVERIA E KOSOVËS - GOVERNMENT OF KOSOVO - VLADA KOSOVA

MINISTRIA E PUNËS DHE MIRËQENIES SOCIALE  
MINISTRY OF LABOUR AND SOCIAL WELFARE  
MINISTARSTVO RADA I SOCIJALNE ZAŠTITE

Në përputhje me Rregulloren e UNMIK-ut nr.2001/19, për Degën e Ekzekutivit të Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes në Kosovë, si dhe vendimi i Qeverisë së Kosovës të datës 10.09.2003, me qëllim të krijimit të kushteve më të favorshme, për mbrojtjen sociale, të punëtorëve të Trepçes nën Administrimin e UNMIK-ut dhe minierave me mihje nëntokësore në Kosovë, Ministri i Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale nxjerr këtë:

**UDHËZIM ADMINISTRATIV Nr. 3/2003  
PËR PENSIONIM TË PARAKOHSHËM PËR PUNËTORËT E KOMPLEKSIT  
TREPÇA NËN ADMINISTRIMIN E UNMIK-ut  
DHE MINIERAVE ME MIHJE NËNTOKËSORE NË KOSOVË**

**Neni 1**

- 1.1** Ky Udhëzim Administrativ, ka për qëllim rregullimin, menaxhimin dhe administrimin e pensioneve të parakohshme për punëtorët e Trepçes nën Administrimin e UNMIK-ut dhe minierave me mihje nëntokësore.

**Neni 2**

- 2.1** Përfitues të këtij pensioni të parakohshëm, janë të gjithë punëtorët e Trepçes nën Administrimin e UNMIK-ut dhe minierave me mihje nëntokësore të cilët i plotësojnë këto kritere:
- Të ketë moshën 50-65 vjeç
  - Punëtorët e shpallur të paaftë për punë dhe të paaftë për punë në minierë
  - Të ketë dhjetë (10) apo më shumë vjet përvojë
  - Të jetë banorë i përhershëm i Kosovës

- Nuk marrin asnjë lloj tjetër të pagesës nga Trepça nën Administrimin e UNMIK-ut dhe minierave me mihje nëntokësore në Kosovë
- Të ketë shkëputje të kontratës së punës në Miniera dhe heqje dorë nga beneficionet ose pagesat e mëtejshme nga punëdhënësi.

Personat që nuk i përmbushin këto kritere, në datën e fuqizimit të këtij udhëzimi, do të fitojnë të drejtën kur t’i përmbushin kriteret e përzgjedhjes.

### **Neni 3**

- 3.1.** Lartësia e shumës së pensionit të parakohshëm është 40 €(euro) për punëtorët e Trepçës nën Administrimin e UNMIK-ut dhe minierave me mihje nëntokësore dhe është e njëjtë me Pensionin Bazë, të cilin e administrojnë Administrata Pensionale e Kosovës.
- 3.2** Këto pagesa të pensionit të parakohshëm, do të bëhen për kohën derisa të fillojë implementimi i Ligjit për Pensionet e Parakohshme dhe do të administrohen nga Menaxhmenti i Trepçës nën Administrimin e UNMIK-ut dhe minierave me mihje nëntokësore, në bashkëpunim me Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale.
- 3.3** Menaxhmentet e Trepçës nën Administrimin e UNMIK-ut dhe minierave me mihje nëntokësore, do të jenë përgjegjës për përzgjedhjen e punëtorëve sipas kriterëve të përcaktuara, shqyrtimin e aplikacioneve dhe për administrimin e pagesave.
- 3.4** Pagesat e pensioneve të parakohshme, do të jenë mujore dhe do të paguhen prej 1 Korrikut të vitit 2004 deri në aprovimin e ligjit për pensionim të parakohshëm.

### **Neni 4**

- 4.1** Qeveria e Kosovës do t’i financojë pensionet e parakohshme, duke bërë transferin mujor të parave nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale në Trepçë nën Administrimin e UNMIK-ut dhe minierave me mihje nëntokësore , në përputhje me afatet dhe kushtet që do të parashtrihen në Memorandumin e Mirëkuptimit.
- 4.2** Para se të barten këto transfere, nga Buxheti i Konsoliduar i Kosovës, në Trepçë nën Administrimin e UNMIK-ut dhe minierave me mihje nëntokësore në Kosovë, Menaxhmenti do të pregatisë listën e të gjithë personave të cilët do t’i përmbushin kriteret gjatë kohëzgjatjes së programit. Lista duhet të përfshijë, të gjithë personat që e fitojnë të drejtën për pension të parakohshëm, të cilët duhet të paraqesin të dhënat identifikuese (emri, mbiemri, ditëlindjen, adresën dhe letërnjoftimin e UNMIK-ut).

- 4.3** Asnjë person nuk mund të shtohet në regjistrimin e personave të përzgjedhur gjatë kohëzgjatjes së këtij Programi. Nëse pas shqyrtimit të aplikacioneve dhe nxerrjes së vendimeve, numri aktual i shfrytëzuesëve të pensionit të parakohshëm është më i vogël se numëri i paraqitur në regjistrimin origjinal, bilansi i parave të transferuara do të rikthehet nga Trepça nën Administrimin e UNMIK-ut dhe minierave me mihje nëntokësore në Kosovë në Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale, në pajtim me Memorandumin e Mirëkuptimit.
- 4.4** Pagesat e pensioneve të parakohshme do t'u nënshtrohen kontrolleve financiare sipas rregullave të zbatueshme për shpenzimet e tjera buxhetore.

### **Neni 5**

Ky Udhëzim Administrativ do të zbatohet në menyrë retroaktive nga 01.07.2003.

**Prishtinë, shtator 2003**

**Ministri i MPMS**  
**Ahmet Isufi**

---